

**RELACION  
PËR  
PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE  
PROCEDURAVE TË RINOVIMIT PËR AUTORIZIMET  
INDIVIDUALE PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË DHËNA ME  
KONKURRIM PUBLIK”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN  
TË ARRIHEN**

Projektakti “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit për autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim publik”, vjen si propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 70 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektakt ka për qëllim të miratojë rregullat e procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Projektakti synon të plotësojë kuadrin nënligjor të nevojshëm për zbatimin e Ligjit Nr. 54/2024 si dhe të sigurojë vazhdimësinë për proceset e rinovimeve të zbatuar në këtë sektor sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 496, datë 22.7.2014 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim” i cili do të shfuqizohet me miratimin e këtij projektakti.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN  
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN  
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA  
POLITIKE**

Projektvendimi është parashikuar në Planin Analitik të akteve për vitin 2026, katërmujori i parë. Projektvendimi lidhet me zbatimin e ligjit Nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Projektakti lidhet me përmbushjen e piketave përmbyllëse të Kapitullit 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media” gjithashtu dhe masave të parashikuara në Reformë Agjendën e miratuar me VKM nr. 621 datë 24.10.2024 lidhur me masën 3.1.3, për infrastrukturën digjitale.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka transpozuar Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”, në pikën 4 të nenit 70 parashikon që rregullat dhe procedurat e rinovimit për autorizimet individuale të përdorimit të frekuencave, të dhëna me konkurrim publik dhe për të cilat numri i të drejtave është i kufizuar, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, bazuar në sugjerimet e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Në këtë kuadër, projektvendimi “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit për autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim publik” synon të përcaktojë një kuadër të plotë rregullator për procedurat e rinovimit, duke garantuar një proces të hapur, transparent dhe jodiskriminues, në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Miratimi i projektit i shërben plotësimin të piketave përmbyllëse të Kapitullit 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media” si aktiviteteve të lidhura me masën 3.1.3, të Reformë Agjendës e miratuar me VKM nr. 621 datë 24.10.2024.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 70 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektakti nuk bën përafrim të *acquis communautaire*, por është hartuar në mbështetje të pikës 4, të nenit 70 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cila ka transpozuar nenin 51, të Direktivës 2018/1972/EU, Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike.

### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit për autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim publik”

Projektvendimi përbëhet nga tre nene: neni 1, parashikon miratimin e rregullave dhe procedurave për rinovimin e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim, sipas dokumentit bashkëngjitur projektvendimit, neni 2, përcakton institucionet e ngarkuara për zbatimin e aktit dhe neni 3, parashikon shfuqizimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 496, datë 22.7.2014 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”. Dokumenti bashkëlidhur projektaktit detajon rregullat dhe procedurat e rinovimit, dhe përbëhet nga 10 nene si më poshtë:

- Në nenin 1, përcaktohen kushtet ligjore për rinovimin e autorizimit individual, duke kërkuar përmbushjen e detyrimeve të përdorimit të këtyre frekuencave nga sipërmarrësi, mungesën e detyrimeve që rrjedhin nga për aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë dhe që kufizojnë rinovimin e autorizimit individual, përputhshmërinë me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe mungesën e procedimeve administrative për shkelje nga AKEP.
- Në nenin 2, parashikohet procesi i aplikimit për rinovimin e autorizimit individual, duke përcaktuar afatet, dokumentacionin shoqërues dhe detyrimin e sipërmarrësit për të provuar përmbushjen e kushteve të autorizimit individual dhe atij të përgjithshëm.
- Në nenin 3, parashikohet verifikimi paraprak i kërkesës për rinovim nga AKEP, për të identifikuar pengesat ligjore para se të vijohet me procesin e rinovimit.
- Në nenin 4, përcaktohet zhvillimi i konsultimit publik, si një instrument për vlerësimin e kërkesave të tregut dhe interesit të palëve të interesuara mbi përdorimin e frekuencave në përputhje me nenin 44, të ligjit nr. 54/2024 dhe në përputhje me parashikimin e nenit 70 të ligjit nr. 54/2024.
- Në nenin 5, rregullohet procesi i vlerësimit të plotë të përmbushjes së kushteve të autorizimit individual dhe atij të përgjithshëm, duke përfshirë zbatimin e kushteve teknike të nevojshme për shmangien e interferencave të dëmshme dhe kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike, kushtet financiare dhe të cilësisë së shërbimit, detyrime për aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.
- Në nenin 6, përcaktohen kriteret për vendosjen e çmimit minimal referencë për rinovimin, duke u bazuar në parimet e transparencës, objektivitetit, konkurrencës dhe praktikave të Bashkimit Evropian.
- Në nenin 7, rregullohet procedura e paraqitjes së propozimit nga AKEP tek ministri, në rast se sipërmarrësi ka përmbushur kushtet për rinovim. Propozimi i AKEP për rinovimin mban parasysh përmbushjen e objektivat përgjithshëm të nenit 5, të këtij ligji si dhe kërkesat e pikës 3, të nenit 60, të ligjit nr. 54/2024

- në lidhje me mbulimin që shoqërohet me një propozim mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e autorizimit individual.
- Në nenin 8, parashikohet procedura e negocimit, përfshirë ngritjen e një komisioni ad-hoc, zhvillimin e negociatave mbi çmimin dhe kushtet e pagesës, si dhe formalizimin e marrëveshjes ndërmjet palëve. Në lidhje me këtë proces është ruajtur procesi i zbatuar deri tani sipas VKM nr. 496, datë 22.7.2014 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”.
  - Në nenin 9, përcaktohet një dispozitë kalimtare për autorizimet që përfundojnë brenda vitit 2026, në një periudhë me pak se një vit, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së proceseve, pas shfuqizimit të VKM nr. 496/2014.
  - Në nenin 10, përmban dispozitat përfundimtare, parashikohen procedurat që ndiqen në rast të mungesës së interesit për rinovim, dështimit të negociatave, si dhe mundësia e shtyrjes së përkohshme të vlefshmërisë së autorizimit në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektakti është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Projektakti synon të sigurojë një vazhdimësinë për proceset e rinovimeve të zbatuar në këtë sektor sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 496, datë 22.7.2014 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim” si dhe të pasurojë dhe përditësojë rregullat për këtë proces me kërkesat e ligjit nr. Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Projektakti do të konsultohet përmes e-akteve me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociatorin. Gjithashtu projektakti do të konsultohet me grupet e interesit sikurse operatorët e komunikimeve elektronike që zotërojnë autorizime individuale për frekuenca të dhëna me konkurrim.

# **RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektvendimi nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**DHE**

**MINISTËR**

**Enea Karakaçi**